



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 29573/2010

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Hoxha nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 7 par.1 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 27, 73, 74, 195 si dhe konformë nenit 198 al.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet merrë:

### AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Islam Hoxha e lindur më 23.08.1973 në Gjakovë ndërsa me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rruga "Pjetër Bogdani" pn, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, dhe Kontrollën e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, konformë nenit 27 dhe 198 par.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Procedura pezullohet për shkak të parashkrimit absolut të veprës kundërvajtëse.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesës.

### Arsyetim

**Agjencia Kundërkorrupsionit në Prishtinë** parashtron kërkesën nr.01/3267/010 të dt.29.09.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Islam Hoxha sepse si zyrtare e lartë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë AKK me rastin e marrjes së detyrës në afatin e caktuar ligjor. Për këtë kundërvajtje me aktvendimin nr.regj.29573/2010 të dates 29.06.2011 e njëjta është shpallë e fajshme dhe është gjobitë me gjobë në shumë prej 200 EU si dhe është ngarkuar me paushallin gjyqësor në shumë prej 5 EU.

Në bazë të ankesës së parashtruar nga e pandehura, Gjykata e Lartë në Prishtinë me aktvendimin "GjL" nr.1144/2011 të dates 27.09.2011, e Abrogon aktvendimin e shkallës së pare për plotësim procedure dhe rivendosje.

Me rastin e rivendosjes që është bërë në vështrim të nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë me aktvendimin nr.regj.29573/2010, të dates 02.07.2012, ndaj të pandehurës së përmendur më lartë e Pezulloi procedurën konformë nenit 198 al.1 pika 8 të LMK-së, i cili aktvendim përsëri është Abroguar nga Gjykata e Lartë në bazë të ankesës së parashtruar nga AKK në Prishtinë me aktvendimin "GjL" 956/2012, të dates 27.08.2012, e në bazë të të cilit është obliguar Gjykata e shkallës së pare që ti kryejë edhe disa veprime procedurale duke mos e marrë për bazë faktin se ka ardhë deri te parashkrimi absolut i veprës kundërvajtëse.

1 / Selim  
Nga shkresat e lëndës shihet se e pandehura Flutra Hoxha e ka filluar punën në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal si ushtruese e detyrës së drejtorit të Departamentit për hulumtim dhe reformë të pushtetit lokal, pikërisht më date 22. Qershor 2010.

Sipas ligjit e njëjta ka qenë e obliguar që në afat prej 30 ditësh ta deklarojë pasurinë me rastin e marrjes së detyrës dhe këtë deri më date 23. Korrik 2010. Pasi që Gjykata konstatoi se që nga data 24. Korrik 2010, e cila konsiderohet si date e kryerjes së veprës kundërvajtëse kanë kaluar më tepër se dy vite dhe nuk është vendosur me aktvendim të formës së prerë, është shkaktuar parashkrimi absolut i veprës për çka në vështrim të nenit 198 par.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u pezullua procedura dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë 8 ditë pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksë..

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
Me dt. 13.09.2012

**KRYETARI GJYKATËS**

Mustafë Selimi

